



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF
GJAKOVA

GJAKOVA



Zyra e Prokurimit
Komuna e Gjakovës

Në bazë të nenit 72.1 të Rregullores për Prokurim Publik të dt. 01.11.2022, e plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren Nr. 002/2024, nenit 37 të Kushteve të Përgjithshme të Kontratës (KPK) në lidhje me kontratën me numër të prokurimit: 632-19-7343-5-2-1 dhe numër të brendshëm 632-19-090-521 dhe nr. të protokollit 01nr.410/04-22322, për shkak të mos-përmbyshjes së obligimeve kontraktuale nga ana e Kontraktorit: Company"Bejta Commerce" SH.A & Eurocom shpk & King Holding shpk - Gjilan, me nr.biznesit 810274150 & 70481414 & 71361292, në bazë të kompetencave dhe përgjegjësi ligjore, më dt. 07.08.2025, Zyrtari përgjegjës i prokurimit, Ju njofton:

NJOFTIM
Për ndërprerjen e Kontratës

Neni 37 i KPK përcakton se "Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi mund të shkëpus Kontratën në qoftë se pala tjetër shkakton një shkelje themelore të Kontratës".
Shkelja themelore e kontratës do të përfshijnë, por nuk do të kufizohet në:

37.1 Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi mund të shkëpus Kontratën në qoftë se pala tjetër shkakton një shkelje themelore të Kontratës.

37.2 Shkelja themelore e kontratës do të përfshijnë, por nuk do të kufizohet në:

a. Kontraktuesi ndërprende punën për 15 ditë rresht pa qenë e përfshirë kjo ndërprerje në programin e punës si dhe pa autorizim të menaxherit të projektit;

b. Menaxheri i projektit urdhëron Kontraktuesin pa arsye të justifikuar të ndërpresë apo pezullojë aktivitetin e punëve të kontraktuara për më shumë se 15 ditë pune; ose marrëveshjet e arritura mbi pagesat për shkak të kontraktuesit për kosto të vonësës;

c. Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi falimenton apo hyn në likuidim tjetër nga rindërtimi ose shkrirja;

d. Pagesa e vërtetuar nga Menaxheri i Projektit, nuk paguhet nga Autoriteti Kontraktues brenda 30 ditësh nga data e certifikatës së Menaxherit të Projektit;

e. Menaxheri i Projektit njofton se mos korigjimi i defekteve është shkelje e kontratës dhe Kontraktuesi nuk arrin t'i korigjoj brenda 30 ditëve të përcaktuara nga ana e Menaxherit të Projektit;

f. Kontraktuesi vonohet në përmbyshjen e kontratës për numrin e ditëve për të cilat shuma minimale e dëmeve të likuiduara mund të paguhet.



37.3 Kur pala tjetër kontraktuese bën shkelje të kontratës për raste të tjera nga ato të parapara me Nenin 37.2, Menaxheri i Projektit do të vlerësojë nëse shkelja materiale e kontratës paraqet bazë për shkëputje të kontratës.

37.4 Nëse për shkak të fajit të palës së tretë krijohen rrethana emergjente objektive dhe kjo e pengon përmbushjen e detyrimeve të kontratës, Menaxheri i Projektit me pëlqimin e Kontraktuesi do të përfundoj vazhdimësinë e përmbushjes së punëve sa më pare që është e mundur. Menaxheri i Projektit do të bëjë vlerësimin e punës së kryer pjesërisht, do të kërkojë nga kontraktuesi të largohet nga zona e punës dhe ta lënë atë në një gjendje të mirë. Menaxheri i Projektit duhet të paguajë kontraktuesin për punët e kryera deri në momentin e marrjes së njoftimit me shkrim për ndërprerje.

37.5 Në qoftë se kontrata shkëputet, Kontraktuesi do të ndërpres punën menjëherë, do të siguroj vend punimin dhe ta liroj vend punimin brenda 15 ditëve nga përfundimi i periudhës së njoftimit.

Ju informojmë se kontrata e nënshkruar me datën 01.10.2020, me numër të prokurimit: 632-19-7343-5-2-1 dhe numër të brendshëm 632-19-090-521 dhe nr. të protokollit 01nr.410/04-22322, me titull 'Rivitalizimi i Eshnores-Çabrat në Gjakovë-Kontratë dy vjeçare', ne mes të Komunës së Gjakovës dhe Punë kryesit Company"Bejta Commerce" SH.A & Eurocom shpk & King Holding shpk - Gjilan, do te ndërpritet me date,08.08.2025.

Kontrata do te ndërpritet duke u bazuar ne nenin 37, paragrafët, a dhe f te Pjesa II e Kontratës – Kushtet e Përgjithshme.

Për mos realizimin e punëve konforme kushteve të kontratës jeni të informuar disa here nga Menaxheri i Kontratës.

Përkundër vërejtjeve të shumta ju nuk ndërmorët veprime të nevojshme për përmirësim te dinamikës për realizimin e punëve.

Si Autoritet Kontraktues që kemi zhvilluar aktivitetin e prokurimit dhe kemi nënshkruar kontratën, ju informojmë se menjëherë pas datës 08.08.2025, do ti ndërmarrim të gjitha veprimet konforme kushteve te kontratës

Shkresës i bashkëngjitet kërkesa për shkëputjen e kontratës dhe raporti mbi ecurinë e punimeve .

Me respekt,

Udhëheqës i zyrës së Prokurimit

The image shows a handwritten signature in blue ink over a circular official stamp. The stamp contains the text 'REPUBLIC OF ALBANIA' and 'Ministry of Economy and Finance' around the perimeter, with 'Gjakova Municipality' in the center. The signature is written across the stamp.



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS



OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

DATE:	04.08.2025
PËR/ZA/TO:	Komuna e Gjakovës Zyrës së Prokurimit - z. Faton Gutaj
KOPJE:	Organi Mbikëqyrës " AI Engineering" , Prishtinë - Valdrin Zenuni Grupi i OE – N.T.Sh. " Marash – Shped" ; SH.P.K COMPANY " BEJTA COMERCE" SH.A rr. Sadik Stavileci K. Gjakovë
PËRMES/PREKO/THRU	Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport- . Fisnik Caka – Mbikqyrsi i Drejtperderjet i Ekipit per Menaxhimin e Kontrates
NGA/OD/FROM	FAZA I : Rexhe Rexha, Naser Kendusi, dhe Valdrin Zenuni faza I (Anëtarët e Ekimit Menaxhues të Kontratës (faza I) të caktuar me dt. 12.06.2025
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Kërkesë për ndërprerjen e kontratës për projektin "Rivitalizimi i Eshtnores" – Faza I, Qabrat Faza I : Nr. prokurimit: 632-19-7343-5-2-1; Nr. kontratës: 632- 19-090-521/C221 Vlera (me TVSH): 98,527.55 € e lidhur me 01.10.2020

Të nderuar,

Në cilësinë tonë si **komision për menaxhimin e kontratës për Fazën I**, ju drejtohem me këtë kërkesë zyrtare për **ndërprerjen e kontratës** të projektit "**Rivitalizimi i Eshtnores**", për arsye si më poshtë:

Pamundësia për të siguruar mbikëqyrje dhe kontroll efektiv për shkak të personit – menaxherit të kontratës (i cili është pensionuar) në komisioni kemi hasur në vësh tersi për shkak të mungesës së të dhënave zyrtare dhe teknike të nevojshme për fazën I, komisioni

i ka mbledhë shënimet , është bërë preja e punimeve të pa përfunduara nga Grupi i OE nuk ka përmbushë detyrat sipas paramases;

Në cilësinë e komisionit për menaxherit të kontratës për **fazën e parë për perfundimin e punimeve të Eshnores në Qabrat**, shkak të **mos kryerjes se punimeve për fazën e parë**, me të cilën e kemi bërë prerjen, ku kemi te njejtat veshtersi që e bëjnë të pamundur vazhdimin e projektit me standardet ligjore dhe profesionale.

Përmes shqyrtimit të gjendjes aktuale në terren dhe dokumentacionit të dorëzuar, është vërejtur se:

Punimet e fazës së parë, dhe mungesa e moskryerjen e punimeve per fazen e parë e bën të pamundur realizimin e punimeve;

Kjo situatë **rezikon zbatueshmërinë, cilësinë dhe transparencën e projektit**, si dhe cenon parimet e menaxhimit profesional të kontratës.

Për këto arsye, propozojmë **ndërprerjen e kontratës**, sipas dispozitave ligjore në fuqi, me qëllim të mbrojtjes së interesit publik dhe profesionalizmit institucional.

Ju lutem që pas pranimit të kësaj kërkesë, të ndërmerren hapat e nevojshëm administrativë për procedurën e ndërprerjes së kontratës.

Kësaj shkrese ja bashkangjesim edhe komplet dokumentacionin e fazës se parë dhe fotot.

Faleminderit për mirëkuptimin.

Me respekt,

EKIPI PER MENAXHIMIN E KONTRATES

1. Rexhë Rexha

2. Valdrin Zenuni

3. Naser Kënduesi





Data: 12.08.2022
Për Investitorin: Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, Komuna e Gjakovës
Projekt Menaxher: Shkelzen Rruka
Organi Mbikëqyrës: AL Engineering sh.p.k
Koha e Raportimit: 2022

Raport mbi ecurinë e punimeve për vitin 2022





Data: 12.08.2022

Për Investitorin: Drejtoria për Kulturë, Rinë dhe Sport, Komuna e Gjakovës

Projekt Menaxher: Shkelzen Rruka

Organi Mbikëqyrës: AL Engineering sh.p.k

Koha e Raportimit: 01.02.2022 – 12.08.2022

Referenca nr.: 003/090

Tifulli i Kontratës: Rivitalizimi i Eshnores – Çabrat në Gjakovë, Kontratë dy vjeçare,
Nr. Iden. 090

Punëkryesi: Company "Bejta Commerce" SH.A. & "Eurocom" sh.p.k.

Vlera e kontratës: 98,527.55€

Informatat e proj.: Eshnore (Renovim)

Të nderuar,

Fillimisht po ju njoftoj që asnjë punë nuk është zhvilluar në këtë vit (2022). Punimet në Eshnore kanë ngecur sepse kanë dalë disa pozicione që nuk kanë qenë në paramasën e kontraktuar dhe janë shumë të domosdoshme që punimet të kryhen ashtu siç është më së miri. Janë një mori pozicionesh të cilat janë në sasi të vogla, mirëpo unë po i ceki disa më kryesoret dhe më të domosdoshmet:

- Hidroizolimi i kulmit (ka pasur rrjedhje të shiut brenda objektit dhe ka qenë e pamundur që të vazhdohet me punimet tjera si: molerim dhe instalime elektrike)
- Shtresa rrafshuese e ybercukut (pa u punuar kjo shtresë nuk mund të vazhdohet me punimin e pllakave nga qeramika)
- Punimi i rampave për personat me nevoja të veçanta
- Punimi i pjesës ku do të vendosen arkivolet
- Pllaka e granitit me mbishkrimin e emrave dhe datave
- Sanimi i pllakave të hyrjet me granit dhe mbushja e fugave të kalldërmit etj.

Ne ju sugjerojmë që të sigurohen njetet për përfundimin e këtyre pozicioneve që mungojnë dhe që do t'a kompletinin këtë projekt në tërësi.

Vërejtje: Afati për përfundimin e kësaj faze është deri në fund të këtij viti dhe do të ishte mirë që sa më shpejt që të jetë e mundur të punohet edhe me fazën e dytë në mënyrë që mos të kemi ngecje në planin dinamik të punimeve (ku dihet që për shkak të disa pozicioneve që duhet të dalin në fazën e dytë është e kushtëzuar edhe faza e parë).

Organi Mbikëqyrës:

"AL Engineering" sh.p.k.

